

**VENDIM**

Nr. 1051, datë 23.12.2015

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË
FINANCIVE PËR SHLYERJEN E
DETYRIMEVE TË HUAS, NË KUADËR
TË MARRËVESHJES, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME
SHOQËRINË “ELBER” SHPK, DHE KfW,
PËR PROJEKTIN DHE HUAN PËR
NDËRMARRJEN E UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE NË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë me “Elber”, sh.p.k., dhe KfW, për projektin dhe huan për Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve në Elbasan, të ratifikuar me ligjin nr. 8801, datë 17.5.2001, dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Financave për shlyerjen e detyrimeve të huas, në kuadër të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë me shoqërinë “Elber” sh.p.k., dhe KfW, për projektin dhe huan për Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve në Elbasan, në shumën 1 160 715 505 (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesë) lekë dhe interesa deri në muajin qershor 2015, në shumën 61 176 418 (gjashtëdhjetë e një milionë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

2. Ngarkohet Ministria e Financave, që, në zbatim të pikës 1, të këtij vendimi, çdo vit të parashikojë në buxhetin e miratuar shumën për shlyerjen e detyrimit përkatës.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe shoqëria “Elber” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 1052, datë 23.12.2015

**PËR DEKLARIMIN E ETALONEVE
KOMBËTARE TË MATJEVE DHE
MBAJTËSIT E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Të deklarojë si etalone kombëtare të njëjësive të matjes në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë vijon:

I.1 Në fushën e masës:

I.1.1 Set gramarësh, i prodhuar nga kompania Hafner GmbH, numri serial 1890810, i klasës së saktësisë E1, diapazon matjeje 1mg-5kg.

I.1.2 Gramar, i prodhuar nga kompania Hafner GmbH, numri serial 6690810, i klasës së saktësisë E1, diapazon matjeje 10kg.

I.2 Në fushën e densitetit:

I.2.1 Sferë silikoni 200g, prodhim i kompanisë Silisiumbearbeitung Andrea Holm GmbH, numri serial 21120037.

I.3 Në fushën e forcës:

I.3.1 Regjistruer force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z3, numri serial J09122, diapazon matjeje 10N-100N.

I.3.2 Regjistruer force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z3, numri serial J12137, diapazon matjeje 20N-200N.

I.3.3 Regjistruer force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z30A, numri serial 33330049, diapazon matjeje 50N-500N.

I.3.4 Regjistruer force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z30A, numri serial 133330045, diapazon matjeje 0,1kN-1kN.

I.3.5 Regjistruer force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z30A, numri serial 143730050, diapazon matjeje 0,2N-2 kN

I.3.6 Regjistruer force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z3H2, numri serial J12192, diapazon matjeje 0,5kN -5kN.

I.3.7 Regjistruer force, prodhuar nga kompania GTM, tipi Z4, numri serial 001-54115, diapazon matjeje 20kN-200kN.



I.3.8 Regjistrues force, prodhuar nga kompania HBM, tipi Z4A, numri serial 094830035, diapazon matjeje 50kN-500kN.

I.3.9 Regjistrues force, prodhuar nga kompania GTM, tipi ZST, numri serial 56262, diapazon matjeje 60kN-600kN.

I.3.10 Regjistrues force, prodhuar nga kompania HBM, tipi C3H2, numri serial H 67600, diapazon matjeje 100kN-1MN.

I.3.11 Regjistrues force, prodhuar nga kompania GTM, tipi KTN-DZY, numri serial 56229, diapazon matjeje 0,2MN-2MN.

I.3.12 Regjistrues force, prodhuar nga kompania HBM, tipi KDB, numri serial 092940001, diapazon matjeje 0,2MN-2MN.

I.3.13 Regjistrues force, prodhuar nga kompania HBM, tipi C18, numri serial 00285CAI, diapazon matjeje 0,3MN-3MN.

I.4 Në fushën e gjatësisë

I.4.1 Set kalibra xhonson, klasa “K” e saktësisë, tipi M121, numri serial 6044, sasia 122 copë, me diapazon nga 0,5 mm deri 100 mm.

I.4.2 Set kalibra xhonson, klasa “K” e saktësisë, tipi M121, numri serial 6045, sasia 122 copë, me diapazon nga 0,5 mm deri 100 mm (të dy setet material çelik).

I.5 Në fushën elektrike

I.5.1 Standard Reference DC, prodhim i kompanisë Fluke, tip 732B, numri serial 9255701.

I.5.2 Rezistenca standard, prodhim të kompanisë Tettex, me diapazon 1 ohm deri 1Mohm, respektivisht me numra serial: 3274, 3275, 3276, 3277, 3278, 3279 dhe 3280. (Mbajtës i etaloneve Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Universiteti Politeknik i Tiranës).

I.6 Në fushën e presionit

I.6.1 Instrument matës (balancë presioni) digjital me dy sisteme matës, prodhim i kompanisë DH Budenberg, tipi DPG 10A gaz dhe DPG 10A vaj gaz, numrat serialë 9987, 9988, 9990, kufijtë e matjeve: 0 bar – 2 bar dhe 0 psi – 1000 psi, presion jo – absolut.

I.6.2 Balancë presioni me dy kufij matjeje: kufiri i ulët 1 bar – 70 bar dhe kufiri i lartë 10 bar – 700 bar, presion jo – absolut; prodhim i kompanisë DH – Budenberg; tip 580DX, numri serial 297K, numri serial i setit të gramarëve A8912.

I.7 Në fushën e termometrisë

I.7.1 Qelizë pike 3 fishe uji, prodhim i Hart Scientific, tipi 5901A, numrat serialë G5031,

G5029, kufijtë e matjeve: 0.01 °C.

I.7.2 Qelizë pike 3 fishe uji, prodhim i Isothec, tipi B11-50-270, numri serial B11 50 1013Q, kufijtë e matjeve: 0.01 °C.

I.7.3 Qelizë pike fikse merkuri, prodhim i Hart Scientific, tipi 5900, numri serial Hg 06157, kufijtë e matjeve: -38.8344 °C.

I.7.4 Qelizë pike fikse galiumi, prodhim i Isothec, tipi 17401, numri serial Ga510, kufijtë e matjeve: 29.7646 °C.

I.7.5 Qelizë pike fikse indiumi, prodhim i Isothec, tipi 17668, numri serial In166, kufijtë e matjeve: 156.5985 °C.

I.7.6 Qelizë pike fikse kallaji, prodhim i Isothec, tipi 17669, numri serial Sn236, kufijtë e matjeve: 231.928 °C.

I.7.7 Qelizë pike fikse zinku, prodhim i Hart Scientific, tipi 5906, numri serial Zn06054, kufijtë e matjeve: 419.527 °C.

I.8 Në fushën e lagështisë

I.8.1 Gjenerator lagështie, prodhim i E+E Elektronik Austri, tipi Humor 20, numri serial 111503000521, kufijtë e matjeve: 10% deri në 95%.

I.8.2 Matës i pikës së vesës, prodhim i Michell Instruments SRL, tipi S 8000, integrale, numri serial 136463, kufijtë e matjeve: 90°C deri në 90 °C.

I.9 Në fushën e volumeve

I.9.1 Kontalitär, prodhim i kompanisë SAMPI SPA, tipi M7-4, numri serial 1403920-02, diapason matjes: 50-500 L/min.

I.10 Në fushën e kimisë

I.10.1 Analizuesi i alkoolit në frymëmarrje, prodhim i kompanisë Drager, Alcotest, tipi 7110 evidental, numri serial ARCJ -00096.

I.10.2 Matës gaz, tipi rrotullues, prodhim i kompanisë Ritter, tipi TG 10, model 1, numri serial 0.53B.E74/201.

I.10.3 Pajisje për kontrollin e rrjedhjes, prodhim i kompanisë MKS Instrument, PR 4000B, tipi 1179, numri serial G503953G20, G503952G20.

II. Vlerat e etaloneve kombëtare të njësive të matjeve të lartpërmendura, si dhe pasiguritë e tyre, përcaktohen nga procesi periodik i kalibrimit në institutet homologe të vendeve të tjera, që kanë të deklaruar aftësitë matëse dhe kalibruese në bazën e të dhënave të BIPM-së (*Bureau International des Poids et Measures*).

III. Mbajtës i etaloneve kombëtare, të përmendura më sipër, është Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, përveç etalonit



kombëtar të përcaktuar në pikën I.5.2, mbajtës i të cilit është Universiteti Politeknik i Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1056, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT
TEKNIK “PËR SIGURINË E
ASHENSORËVE NË PËRDORIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 16, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLI TEKNIK
PËR SIGURINË E ASHENSORËVE NË
PËRDORIM

1. Fusha e zbatimit

Ky Rregull Teknik zbatohet për të gjithë ashensorët ekzistues (që janë në përdorim) dhe për ashensorët e rinj, të cilët instalohen në ndërtesa në bashkëpronësi, në ambiente shtëpiake ose në vendin e punës, përfshirë edhe komponentët e tyre të sigurisë me qëllim për të garantuar sigurinë gjatë gjithë periudhës së përdorimit të tyre.

2. Përkufizime

Në këtë Rregull Teknik termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

2.1 “Struktura Përgjegjëse” është struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut nën ministrinë përgjegjëse për tregtinë.

2.2 “Certifikatë regjistrimi” është certifikata e lëshuar nga struktura përgjegjëse lidhur me regjistrimin e një ashensori në zbatim të pikës 4 të këtij Rregulli Teknik.

Kërkesa për regjistrim bëhet nga personi përgjegjës, si referohet në pikën 24, të nenit 3, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar.

2.4 “Ashensor ekzistues” është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim përpara datës 31 dhjetor 2009.

2.5 “Ashensor i ri” është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim duke filluar që prej datës 1 janar 2010.

2.6 “Modifikim i rëndësishëm” është çdo ndryshim/modifikim në ashensor, i cili mund të rrezikojë sigurinë e tij dhe minimalisht përfshin:

2.6.1 Për ashensorët ekzistues dhe të rinj të tipit elektrik,

a) ndryshimi i:

i) shpejtësisë nominale;

ii) ngarkesës nominale;

iii) masës së kabinës;

iv) korsës lëvizëse (lartësisë);

b) ndryshimi ose zëvendësimi i:

i) tipit të pajisjes për mbylljen e dyerve në sheshpushim (zëvendësimi me të të njëjtit tip nuk konsiderohet modifikim i rëndësishëm);

ii) sistemit të kontrollit;

iii) shinave udhëzuese ose i tipit të shinave udhëzuese;

iv) tipit të derës (ose shtimi i një ose më shumë sheshpushimeve ose i dyerve në kabinë);

v) agregatit ose sistemit tërheqës;

vi) kufizuesit të mbishpejtësisë;

vii) mjeteve mbrojtëse të lidhura me mbi-shpejtësinë e kabinës gjatë ngritjes;

viii) amortizatorëve;

ix) mekanizmit mekanik të sigurisë.

2.6.2 Për ashensorët ekzistues dhe të rinj të tipit hidraulik,

a) ndryshimi i:

i) shpejtësisë nominale;

ii) ngarkesës nominale;

iii) masës së kabinës;

iv) korsës lëvizëse (lartësisë);